



**United
Nations**



**PEACEBUILDING
FUND** 

**UN
WOMEN** 

Barazia Gjinore dhe Pjesëmarrja e Grave dhe Vajzave në Sport në Shqipëri: Një Vlerësim dhe Udhëzues për Çështjet Gjinore në Sport.

Në vitet e fundit, sporti është kthyer në një mjet të rëndësishëm për fuqizimin e grave dhe vajzave në nivel global. Sporti kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm dhe sfidon normat gjinore, duke promovuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Megjithatë, gratë dhe vajzat vazhdojnë të përballen me pengesa për shkak të normave shoqërore.

Ky dokument mbështetet në studimin “Barazia Gjinore dhe Pjesëmarrja e Grave dhe Vajzave në Sport në Shqipëri: Një vlerësim dhe udhëzues për çështjet gjinore në sport”, i cili shqyrton dinamikat e çështjeve gjinore në fushën e sportit dhe ofron të dhëna dhe rekomandime për adresimin e nevojave të grave dhe vajzave në sport (futboll, volejboll dhe basketboll).



YOUth

Inclusion, Equality & Trust



Shkalla e Pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në sport është përmirësuar me kalimin e kohës, por mbetet ende e kufizuar, veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi ndryshe që përballen me pengesa shtesë. Disa sporte tradicionalisht të lidhura me burrat shfaqin përfshirje veçanërisht të ulët të grave dhe vajzave.

17 nga 22 federata sportive në Shqipëri kanë më pak se 40 % anëtare gra dhe vajza. Gjimnastika (72%) dhe volejboli (99%) kanë përqindjen më të madhe të grave, ndërsa mundja (99%) dhe skijimi (94%) i kanë burra pothuajse të gjithë anëtarët. Vetëm Federata e Badmintonit është pranë arritjes së një balance gjinore (54% gra kundrejt 46% burra).

1



2

Të dhënat e paraqitura në Dokumentin Strategjik të Federatës Shqiptare të Futbollit "Futbolli për Kombën – 2022 – 2025", konfirmojnë se pjesëmarrja e grave mbetet e ulët mes lojtarëve të regjistruar në garat kombëtare dhe rajonale.

Sipas Strategjisë për Futbollin e Vajzave në Shqipëri, përgatitur nga Federata e Futbollit, në vitin 2022 në Shqipëri ishin të regjistruara mbi 2000 vajza futbolliste (profesioniste dhe jo profesioniste).

3



4

Në vitin akademik 2021-2022, Universiteti i Sporteve në Tiranë kishte 1576 studentë të regjistruar (513 vajza), duke evidentuar një pabarazi të theksuar gjinore në interesin për sportin.

Nga periudhën 2019-2023, të dhënat e Lojërave Olimpike Speciale tregojnë se gratë dhe vajzat me aftësi ndryshe vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara në sport në krahasim me kolegët e tyre burra, me 1311 sportistë (444 gra, 867 burra) dhe 168 trajnerë (24 gra dhe 144 burra) me aftësi të kufizuara intelektuale.

5





Gjetjet Kryesore

Gratë janë dukshëm më pak të përfaqësuara në pozicione dhe role të larta drejtuese në organizatat sportive, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal, duke penguar pjesëmarrjen dhe ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse.



Të 22 Federatat e Sporteve Olimpikë drejtohen nga presidentë burra. Nga 14 pozicione nënkryetari brenda Federatës Kombëtare të Sporteve Olimpikë, vetëm 2 poste të tilla mbahen nga gra. Gratë zëvendëspresidente përbëjnë 29% në Komitetet Olimpikë dhe 81% në Federatat e Sporteve Olimpikë. Në përgjithësi, gratë mbajnë 22% të pozicioneve në bordet drejtuese në të dyja organizatat.



Situata në Federatën e Volejbollit është pozitive, ku gratë përfaqësojnë 50% të Komitetit Ekzekutiv dhe më shumë se 50% të sportistëve dhe të nivelit më të lartë drejtues.



Gratë janë të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e profesionit të trajnerit në Shqipëri, veçanërisht në atë elitare, për shkak të stereotipeve dhe mungesës së mbështetjes institucionale. Në vend ka 25 trajnere gra krahasuar me 88 trajnerë burra. Gratë trajnere janë më aktive në sporte ku dominojnë vajzat e gratë. Ato punojnë me gra, adoleshentë ose fëmijë. Në ekipet elitare, ato zakonisht shërbejnë si asistente të trajnerëve kryesorë burra.



Sportet për burra dominojnë në raportimet mediatike. Kur sportet e vajzave dhe grave raportohen, fokusi shpesh përforcon stereotipet gjinore. Në nivel global, vetëm 4% e përmbajtjes së mediave sportive i kushtohet sportit për vajzat dhe gratë, ku fokusi vendoset më shumë tek pamja, mosha dhe jeta personale sesa tek aftësitë sportive (UNESCO).



Për vitin 2018, 90% e redaktorëve sportivë dhe 88.5% e reporterëve ishin burra. Vetëm 12% e lajmeve sportive prezantohen nga gra. Mbi 85% e raportimit në medianë e shkruar i kushtohet sportistëve burra; koha e transmetimit për sportet e vajzave dhe grave gjithashtu është shumë e vogël.



Vetëm 2 federata sportive, Federata e Futbollit dhe ajo e Peshëngritjes, kanë miratuar në 2016-ën një politikë dhe/ose plan veprimi të shkruar për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore në sport. Tri federata sportive (futbolli, taekwondo dhe volejboli) kanë ndërmarrë nga viti 2015 masa për parandalimin dhe luftën kundër fenomenit.



Investimet e pamjaftueshme në sportet e grave dhe vajzave, duke përfshirë financimin dhe shpërndarjen e burimeve, pengojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave. Investimet e pamjaftueshme në objektet dhe pajisjet sportive i përkeqësojnë më tej këto pabarazi.



Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme janë përshtatur për aktorët kryesore të interesit, duke nënvizuar disa nga veprimet që ata mund të ndërmarrin për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës dhe të barabartë në sport.



Për Autoritetet e Qeverisjes Qendrore:

- ▶▶ Miratimi ose rishikimi i legjislacionit dhe i politikave për sportin për të integruar barazinë gjinore, dhe për të garantuar që barazia gjinore të përfshihet në kurrikulat e edukimit fizik dhe sportit në shkolla.
- ▶▶ Integrimi i perspektivës gjinore në proceset buxhetore të lidhura me sportin për të promovuar akses të barabartë në burimet sportive për gratë dhe vajzat.
- ▶▶ Zbatimi dhe monitorimi i politikave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore në sport.
- ▶▶ Bashkëpunimi me OSHC-të për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në sport përmes mbrojtjes dhe përpjekjeve në terren.
- ▶▶ Miratimi i kuotave gjinore në vendimmarrjen për sportin si një kërkesë e detyrueshme.



Për Autoritetet e Qeverisjes Vendore:

- ▶▶ Investime në sport, veçanërisht në sportet për gratë dhe vajzat dhe për fuqizimin ekonomik të tyre.
- ▶▶ Rritja e ndërgjegjësimit për aktivitetet sportive të disponueshme dhe rritja e mbështetjes financiare për aksesin në këto shërbime, veçanërisht tek të rinjtë.
- ▶▶ Sigurimi i infrastrukturës së aksesueshme dhe pajisjeve të përshtatshme sportive në programet sportive lokale, duke përfshirë mjedise të përshtatshme për sportet e grave dhe vajzave.
- ▶▶ Përfshirja e programeve të trajnimit për çështjet gjinore në planet për zhvillimin e kapaciteteve të stafit në nivel vendor.



Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme janë përshtatur për aktorët kryesore të interesit, duke nënvizuar disa nga veprimet që ata mund të ndër marrin për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës dhe të barabartë në sport.



Për Federatat e Sporteve

- ▶ Rritja e investimeve në sportet e grave dhe vazhaje për të mbështetur zhvillimin dhe rritjen e tyre.
- ▶ Kryerja e konsultimeve të gjera me palët e interesuara për të kuptuar më mirë nevojat specifike gjinore dhe për të reaguar në përputhje me rrethanat.
- ▶ Angazhimi i sportistëve, gazetarëve, trajnerëve dhe aleatëve të tjerë burra për të mbrojtur sportet e grave dhe për të advokuar për barazinë gjinore.
- ▶ Zbatimi i politikave dhe procedurave të mbrojtjes për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e të gjithë pjesëmarrëseve.
- ▶ Bashkëpunimi për ndjekjen dhe vlerësimin e progresit të pjesëmarrjes së balancuar të vajzave e djemve, grave e burrave në sporte, përmes krahasimit me treguesit ndërkombëtarë.



Për Komitetin Olimpik:


- ▶ Garantimi i numrit të barabartë të ekipeve dhe sportistëve burra/djem dhe gra/vajza në sport, me përfaqësim të balancuar të të dy gjinive në programet e grave.
- ▶ Promovimi i sportit të sigurt dhe mbrojtja e sportistëve nga ngacimet dhe abuzimet duke alokuar burime nga buxheti operacional.
- ▶ Krijimi i mekanizmave për të rritur numrin e grave kandidatë për role drejtuese, duke përfshirë rekrutimin me një qëllim të caktuar, zhvillimin e lidershipit, mentorimin dhe programet e sponsorizimit.



Për Sektorin Privat dhe Median:

- ▶ Rritja e mbështetjes për ekipet profesioniste të grave dhe vajzave dhe rritja e sponsorizimeve për gratë dhe vajzat sportiste.
- ▶ Vazhdimi i promovimit të mesazheve pozitive të barazisë gjinore në marketingun për sportin për të luftuar stereotipet.
- ▶ Përcjellja e një imazhi jostereotip të grave dhe burrave në sport duke eliminuar përmbajtjen dhe gjuhën seksiste në mbulimin mediatik. Të bëhen përpjekje për kohë transmetimi të balancuar.
- ▶ Sigurimi i pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në mediat sportive përmes punësimit të gazetarëve sportive gra dhe vajza dhe mbështetjes për karrierën e tyre.

 Ky dokument është realizuar në kudër të projektit "Të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim", financuar nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes.

 Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni unwomen.albania@unwomen.org